



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.08.2020 të parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik N.SH. " CLEAN " & "COYOTE CLEAN GROUP" sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e objekteve komunale të Komunës së Gjakovës", me Nr. të Prok: 632-20-1271-2-2-1 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik N.SH. " CLEAN " & "COYOTE CLEAN GROUP" sh.p.k., e dt. 10.08.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e objekteve komunale të Komunës së Gjakovës", me Nr. të Prok: 632-20-1271-2-2-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 06.08.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 06.08.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

Arsyetim

Grupi i Operatorëve Ekonomik N.SH. " CLEAN " & "COYOTE CLEAN GROUP" sh.p.k., me datë 10.08.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e objekteve komunale të Komunës së Gjakovës", me Nr. të Prok: 632-20-1271-2-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.08.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti kontraktues ju ka eliminuar edhe pse i keni ofruar 3 referenca në vlerë 130,000.00€ nuk qëndron sepse në Njoftimin për kontratë dhe në Dosje të tenderit tek **Kapaciteti teknik dhe profesional** është kërkuar që:

"Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 130.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjajshme."

Njoftimi për kontratë është bërë me dt.08.04.2020, që i bie se referencat e juaja duhet të jenë nga dt.08.04.2017/2018/2019/2020. Dy nga referencat tuaja janë para kësaj date (16.03.2015-15.03.2017 dhe 16.03.2015-15.03.2017), që i bie se vetëm njëra referencë është valide- ajo e dt.01.08.2016-31.07.2017, vlera e së cilës është 130,804.29€ (ku valid janë vetëm 4 muaj- muaji 4, 5, 6 dhe 7 d.m.th. $130,904.29 : 12 \text{ muaj} = 10,900.36 \times 4 \text{ muaj} = 43,601.44\text{€}$).

Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Operatori Ekonomik NNP " Blinaja -A.M. ", i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është eliminuar për arsye se nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Eaton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës